



KATALOGU I BOTIMEVE  
2011





LOGOS A

# SHTËPIA BOTUESE LOGOS A KATALOGU I BOTIMEVE 2011

*Drejtor:*  
Adnan Ismaili

*Kryeredaktor:*  
Husamedin Abazi

*Këshilli redaktues:*  
Nexhat Ibrahim  
Dr. Xhevat Lloshi  
Dr. Milazim Krasniqi  
Dr. Ali Pajaziti  
Dr. Zeqirija Ibrahim  
Mr. Muharrem Jahja  
Mr. Sulejman Baki  
Islam Karanfili  
Taxhudin Shabani  
Afrim Gashi

*Redaktor artistik:*  
Edib Ali Agagjyshi

*Disenjator:*  
Halil Berisha

*Shtypi:*  
Focus Print – Shkup

Logos-A – 2011

Pas një pushimi relativisht të shkurtër pas manifestimit “20 vite kryefjalë e mendimit të lirë”, në këtë fundvit, që përkon me panairin e librit në Tiranë, SHB “Logos-A” sjell para lexuesit të saj edhe rreth 50 tituj të rinj. Dhe, kjo jo vetëm për të mos i mbetur borxh 2011-tës, por për ta vazhduar traditën e “50 botimeve të reja në vit”. Aq më tepër që kjo më është bërë një detyrim i yni profesional për vitrinën e librit shqip dhe për pasurimin e vazhdueshëm të kulturës së shkruar shqiptare.

Duke synuar ta mbajmë hapin që gjithnjë të sjellim diçka që do të jetë e veçantë, si për nga cilësia përmbajtësore, ashtu edhe për nga pamja dhe vlerat e shtypit, jemi përkujdesur që edhe gjatë këtij panairi të ofrojmë diçka të këtille.

Është këtu një vepër që është e para e këtij lloji në gjuhën shqipe – monografia “Shkupi”, e shkrimtarit të njohur shqiptar nga Maqedonia Kim Mehmeti, i cili po ashtu duke qëndruar rreth Shkupit, për këtë panair sjell edhe romanin e tij më të ri “Lypsiqarët e Shkupit”. Janë këtu pastaj edhe drama “Lulet e mërziçës” e shkrimtarit Shkëlzen Halimi, përmbledhja poetike “Harta e lotit” e Jonuz Fetahajt, romani për fëmijë “Fluturimi mbi Sllupçan” i shkrimtarit Nehas Sopaj, si dhe përkthimet letrare “Divani” nga mistiku Junus Emre, “Fëmijët e apokalipsit” nga Gursel Donmez, këto të fundit të përkthyer nga turqishtja, si dhe “Rruga për në Mekë” nga Muhammed Asad – një vepër e njohur e kulturës mbarebotërore e përkthyer nga anglishtja.

Bashkë me këto tituj origjinalë letrarë po sjellim në gjuhën shqipe edhe 5 vepra kapitale (në 6 vëllime) për jetën dhe misionin profetit të fundit, që kësaj radhe prezantohen nën titullin e përbashkët “Muhammedi a.s.”, ndërsa vijnë nga penat e shqiptarit Vehbi Sulejman Gavoçi, Muhamed Hamidullahut nga Franca, Osman Nuri Haxhiqit nga Bosnja, Martin Lingsit nga Anglia dhe Mustafa Islamogllut nga Turqia.

Duke qenë se bëhet fjalë për rreth 50 tituj, që vetëm të përmenden janë shumë, ndërsa në faqet në vijim janë prezantuar më hollësisht, neve na mbetet të themi se as kësaj radhe nuk i kemi lënë mangët titujt në bibliotekën “Lexo”, ku kemi autorët: Edward Said, Ibrahim Kallin, Tarik Ramadan, Alesh Debeljak, Qani Nesimi, Ali Pajaziti, Karen Armstrong etj. Në bibliotekën “Fjala” na vjen një titull, disa tituj të rëndësishëm vijnë nën logon “Biblioteka e xhepit”, ndërsa “Botime të veçanta” sjellin Nexhat Ibrahimit me autobiografinë e tij “Kujtime”, Qerim Litën me veprën e vetme në këtë fushë “KQ i NDSH-së dhe Azem Marana”, 10 tituj për maturantë, ku janë disa vepra shkencore, letrare e filozofike, pastaj “365 ditët e jetës pejgamberike”, “Rrëfime pejgamberike për fëmijë” etj.

Marrë në përgjithësi, edhe ky katalog ia ka dalë që të mos dalë faqehollë, por as i varfër për nga cilësia e titujve që sjell.

Tani u mbetet lexuesve që kjo punë të marrë edhe vulën e vlerësimit të tyre. E jona ishte deri këtu!

Gjurmë janë produkt i një vazhdimësie kundrejt ngjarjeve gazetareske ditore, i ndjenjës lokale që kryqëzohet me universalen e një procesi që bashkon të kaluarën me të tashmen, bile edhe me të ardhmen, dhe të gjitha këto të vendosura në një format të përgatitur me një përkujdesje estetike. Gjurmë janë tentim që synon t’i takojë çastet e paregjistruara dhe të pashënuara me kohën në të cilin jetojmë ne. Gjurmë mund të jenë edhe një përgjigje e kërkuar nga e kaluara. Pjesët e tij janë shfaqur si një vazhdë, si një tërësi e përbërë nga imazhe të shpëputura në kohë dhe hapësirë, një kërkim i stimuluar nga brenga e tërësisë.

“Gjurmë”, përpos që është një përgjigje nga e kaluara e dhënë për të tanishmen dhe një grumbull kujtimesh, aq më tepër është përpjekje që t’i çmojë/përkujdeset për çastet e përjetuara dhe ata që i kanë përjetuar, është përpjekje për rishqyrtimin e jetës, është sens për të ndërtuar një botë të re dhe një përpjekje për të ikur nga telashet ditore.

Për asnjërin nga ngjarjet e treguara këtu nuk kam pasur ndonjë shënim të shkruar. Gjërat e rrefyera këtu lexoni si refleksion i gjurmëve që kanë mbetur të fshehura diku në thellësitë e mbamendjes sime.



Përktheu nga turqishtja: Muharrem Mexhiti

**Gjurmë**  
AKIF EMRE

Fq: 288  
133 x 205 mm  
Biblioteka



Përmes këtij libri është bërë përpjekje të analizohen mendimet e Frojdit në lidhje me fenë, si dhe gjykimet tek të cilat ka arritur, duke u nisur nga teoritë e tij psikanalitike. Analizimi i Frojdit ose dalja kundër tij, herë-herë është detyrim për t’u bërë, duke përdorur armën e tij (për shembull, sikurse që ndodh me kërkimin e disa shkaqeve të periudhës fëmijërore të tij, që e kanë çuar atë të paraqesë qëndrime kundër fesë). E, kjo mund të të shihet si një gjendje e cila e nxjerr në të drejtë Frojdin. Vetëm se kjo, në një pikë, është e pashmangshme. Për shkak se studimet (observimet) e tij kanë të bëjnë me fushën shpirtërore-metafizike dhe janë të përshtatshme për spekulime, edhe analizat që do të bëhen do mund të ngelin vetëm në përmasën e spekulimit. Andaj, ndonjëherë forma më e mirë e analizimit mund të arrihet duke vlerësuar prej brenda sistemin e tij të mbyllur.

**Frojdi dhe feja**

ALI KÖSE

Përktheu nga turqishtja: Musa Musai

Fq: 240  
133 x 205 mm  
Biblioteka





## Fundamentalizmi bashkëkohor dhe lufta e shenjtë

ALESH DEBELJAK

Përktheu nga bosnjakishtja: Skënder Latifi

Fq: 126  
133 x 205 mm  
Biblioteka



Në debatet moderne intelektuale për raportet mes religjionit dhe politikës në shtetin modern shekullar, zakonisht kemi punë me shumë terma, të cilat para së gjithash gjuha joprecize e gazetarisë dhe e forumeve të ndryshme mediatike dëshiron t'i përdorë në mënyrë të ndryshme, ndonëse konservatorizmi, tradicionalizmi dhe fundamentalizmi si shprehje më të shpeshta, nuk janë sinonime. Në këtë libër trajtohet një temë e gjerë, së pari duke paraqitur në mënyrë krejt propedeutike dallimet themelore përmbajtjesore mes qëndrimeve religjioze që shënojnë tre termat e cekur më lart. Veçmas përqendrohet në synimin që t'i ndriçojë tiparet më të theksuara strukturale të fundamentalizmit, pa ndonjë thellim të veçuar në analizën shoqërore – historike të fenomeneve të ndryshme fundamentaliste.



## Ortodoksizmi te shqiptarët

QANI NESIMI

Fq: 232  
133 x 205 mm  
Biblioteka



Ortodoksizmi te shqiptarët është një studim shkencor i cili është punuar nga një studiues që nuk i takon religjionit që përpunohet, por edhe në një institucion i cili hulumton teologjinë islame. Raste të ngjashme për sa i përket studimit të islamit nga ana e të krishterëve dhe hebrenjve bazuar në metodën dhe sistematikën e prezantuar në këtë punim ka shumë. Përqendrimi i studimit të Qani Nesimit në Kishën Ortodokse Shqiptare dhe metoda antropologjiko-doktrinologjike e ndjekur në te, tregon edhe më tepër cilësinë unike të këtij punimi. Autori hap shtigjet e analizës dhe hulumtimit serioz të aspektit religjioz ndër shqiptarët. Është më se e vërtetë se jo vetëm Kisha Ortodokse Shqiptare, por edhe organizmat tjera religjioze brenda shqiptarëve janë tejet pak të analizuara dhe hulumtuara ashtu si duhet.

Depërtimi në doktrinën krishtere librin Ortodoksizmi dhe shqiptarët do ta bëjë libër tërheqës për entuziastët, mirëpo edhe doracak për fakultetet teologjike si ndër shqiptarët ashtu edhe më gjerë.

“Shtrembërimi i Islamit është vepër që duhet të lexohet nga çdo korrespondent dhe nga çdo redaktor i lajmeve të huaja.... Është një libër me peshë.”

Frances FitzCerald, autor i “Zjarr në liqen”

Shtrembërimi në paraqitjen e Islamit, sot nuk paraqet as dëshirën më të sinqertë që të kuptohet as vullnetin që të dëgjohet dhe të shihet ajo që mund të shihet dhe të dëgjohet. Larg asaj se raportimet për Islamin janë naive ose pragmatike – fotografitë dhe veprimet me të cilat mediat paraqesin Islamin përballë konsumatorëve të lajmeve, janë armiqësia dhe mosdija për arsye që, aq mirë e ka trajtuar Noam Chomsky në një mori librash. Është fakt se edhe ai pak dialog dhe ato pak shkëmbime, shumë vështirë arrijnë tek opinioni ku aq shumë mbizotërojnë masmediat. Ndjesitë, ksenofobia dhe gjendja e luftës, janë specialitet ditor, dhe rezultatet në të dy anët e linjës së imagjinuar mes “nesh” dhe “atyre”, janë mjaft të paqarta.

Orvatjet e thjeshta, siç është ky libër, do të shërbejnë si kundërhelm që do tregojë se çfarë është shtrembër dhe çfarë mund të bëhet që të zbuten pasojat e mëdha negative të akumuluar kaq shumë.




## Shtrembërimi i Islamit

EDWARD W. SAID

Përktheu nga anglishtja: Skender Latifi

Fq: 342  
133 x 205 mm  
Biblioteka



Një nga fetë më të mëdha të botës gjatë 1500 viteve të ekzistencës së tij, Islami, është gjithashtu më i keqkuptuari. Bota perëndimore ka kryer një revolucion të plotë mendimi në shekujt e fundit, por mosbesimi i saj ndaj Islamit është ende në thelb mesjetar.

Shtatë shekuj nga kryqëzata e fundit, vendet e shenjta islame dominohen nga pusët e naftës; një kohë “Ndëshkimi i Zotit”, tani forcat e tij janë një fyerje për liberalizmin shekullar. Fanatiku “fundamentalist”, shtypësi i femrave, terroristi i pamëshirshëm, tirani: këto janë stereotipet e të pafutur islamik me trend të ri.

Libri i Karen Armstrongut e kapërcen klisheën për të zbuluar një besim i cili ka frymëzuar po aq dijetarë, mistikë dhe poetë sa edhe ushtarë. Ai e bën të qartë se Islami është jo vetëm një nga fetë më të rëndësishme dhe më frymëzuese të botës, por baza për një nga qytetërimet e tij më të ndritura.

“Një rrëfyes tejmbanë me vlerë... si edhe një antidot i shkëlqyer ndaj paragjykitimit.”  
Financial Times

## Islami Një histori e shkurtër

KAREN ARMSTRONG

Përktheu nga anglishtja: Bujar Hoxha

Fq: 324  
133 x 205 mm  
Biblioteka





## Учењето на Ибн Сина

ХАСАН ЦИЛО

Со самото воведување на средновековната филозофија на институтите за филозофија кај нас, а посебно на еврејската, христијанската и на исламската филозофија, веќе подолго време се чувствува потреба за објавување текстови за средновековната филозофија. Прашањата за кои расправа средновековната филозофија се оние актуелни и општи прашања со кои се занимава филозофијата воопшто. Затоа филозофската мисла од средниот век, за која денес во светот се пишува како за едно од поглавјата на филозофијата, со оглед на проблемите за кои расправа, е сè уште жива традиција.

Филозофијата на Ибн Сина во тој контекст, како што ќе покаже истражувањето, одиграла круцијална улога и била од големо значење.



Fq: 224  
133 x 205 mm  
Biblioteka



Politics in time begins with a focus on institutional continuity, in relation with the dependence and positive feedback. Examining the mechanisms that sustain stability over the time is necessary to understand the dynamics of political changes. The history of political systems can be explained in terms of changes in domestic and international political relations.

This book aims to give a general understanding about the various types of dynamics to explain the political changes throughout the history. Particularly, it focuses on the historical background of the emergence of current global liberal economic system or the world system and the internal dynamics of the domestic political systems. In this context, the presidential and parliamentary political structures, partisan-ship, election systems, interest groups, public opinion and the ethnic groups are reviewed in a manner to understand their role on the political changes. The relationships between domestic and international dynamics are also handled by analyzing the Cold War and Past Cold War political systems.



## Dynamics of Political Changes

FEHMI AĞCA

Fq: 286  
133 x 205 mm  
Biblioteka



## Të jesh mysliman evropian

TARIQ RAMADAN

Perkthyen nga anglishtja:  
Rejhan Neziri, Ali Pajaziti



Tashmë ka kaluar një gjeneratë qëkur evropianët perëndimorë kanë filluar të vërejnë se komunitetet myslimane janë duke u ngulitur nëpër qytetet tona. Ditët e punëtorëve të përkohshëm emigrantë janë zëvendësuar me vendosjet e familjeve në një proces i cili ishte e qartë se do të ishte i vazhdueshëm. Filluan të shfaqen xhamitë e para, dhe ne nisëm t'u kushtojmë vëmendje. Kur shikua pas zhvillimeve të sipërfaqshme, zbuluam se myslimanët në Evropën Perëndimore kishin qenë shumë më herët, në disa raste edhe me shekuj të tërë, edhe pse në numër të vogël. Prania e sotme e tyre në Evropën Perëndimore shërben gjithashtu edhe për të na kujtuar tashmë se ka pasur komunitete myslimane të ngulitura mirë në disa pjesë të Evropës Lindore – edhe pse ne kemi menduar se i kemi injoruar në mënyrë të plotë ngase ishin të fshehur pas Perdes së Hekurt. Prania e re na ka rikujtuar praninë tonë në botën myslimane, në formën e perandorisë.

Ajo çka nuk është bërë në mënyrë sistematike më parë në kontekstin bashkëkohor evropian, ka qenë shqyrtimi i burimeve të traditës kryesore dhe dobia e tyre në këtë mjedis të ri. Kjo është diçka që është bërë në mënyrë të gjerë në botën myslimane, veçanërisht në botën arabe myslimane. Tani Dr. Ramadani na ofron përpjekjen e parë madhore për ta zbatuar këtë proces në situatën e myslimanëve në Evropë.

Fq: 376  
133 x 205 mm  
Biblioteka



Islami dhe Perëndimi është një vepër nga të rrallat që arrin përmes kaq pak faqesh të përmbledhë një histori marrëdhëniesh shekullore ndërmjet fesë islame dhe Perëndimit si koncept gjeografik, politik e kulturor. Autori ia del me një qasje dhe analizë të veçantë të paraqesë të gjitha periudhat e kontakteve të islamit me Perëndimit, qofshin ato përmes luftërave e konflikteve, por edhe përmes bashkëpunimit e bashkëveprimit ndërqtetërimor. Ai flet edhe për dobiet e ndërsjella dhe këmbimet e rëndësishme që kanë shënuar këtë histori relacionesh.

## Islami dhe Perëndimi

IBRAHIM KALLËN

Përktheu nga turqishtja: Rubin Hoxha

Fq: 260  
133 x 205 mm  
Biblioteka



## Kultura dhe cilësia e jetesës Rasti Maqedoni

ALI PAJAZITI

Sociologu Ali Pajaziti edhe përmes kësaj vepre arrin të dëshmojë se nuk është sociolog byrosh që merren me teoretizime të thata dhe pa prekur në terren. Duke marrë për bazë Maqedoninë, këtë të vështuar në prizmin e cilësisë së jetesës, ai ia del mjeshtërisht të bëjë një analizë të njëmendtë të këtij spektri dhe këtë ta përcjellë edhe në gjuhën angleze për opinionin shkencor më të gjerë.



Fq: 288  
133 x 205 mm  
Biblioteka



## Ditari i Ramazanit i peygamberit tonë

ALI ÇELIK

Përktheu nga turqishtja: Altin Qefalia



Në këtë libër gjenden njohuritë më të vyera që ne kemi nga shokët e Pejgamberit tonë, duke na treguar se çfarë ka bërë ai gjatë muajit të Ramazanit, si e ka kryer ai adhurimin e agjërimin, veprat e tij në këtë muaj, si dhe këshillat që ata kanë dëgjuar prej tij në lidhje me agjërimin e këtij muaji. Këto njohuri janë një dritë që na tregon disa pasqyrime nga bota shpirtërore e Pejgamberit tonë. Ato janë njohuri të një ditari Ramazani të një personaliteti të shquar, i cili ndërsa iu përshkruante shokëve të tij gradën e mirësisë sinqeritetit në adhurim ndaj Allahut, iu thoshte kështu: "Mirësia është që ta adhurosh Allahun sikur po e shikon Atë. Ndonëse ti nuk e shikon dot Atë, Ai të shikon ty."

Fq: 176  
133 x 205 mm  
Biblioteka



Njohja e metafizikës islame, sidomos me thellësinë dhe analizën që synon kjo vepër, ka qenë dhe mbetet gjithnjë sfidë e studiuesve më të mëdhenj të religjionit. Megjithatë pak prej tyre ia dalin që kaq bukur dhe me gjuhë kaq të qartë të flasin për një çështje aq jofizike, siç është metafizika e Islamit. Autori, një mendimtar i lindur nga Malajzia, edhe përmes kësaj vepre dëshmon se posedon aftësi studimi të rrallë që t'i qaset dhe t'ia dalë me sukses të sjellë një vepër që në studimet islame shqiptare do të jetë bazë për njohjen e metafizikës së islamit – diçka që deri tash i ka munguar plotësisht kulturës sonë islame.



## Hyrje në metafizikën e Islamit

SEJJID MUHAMMED NAKIB EL-ATTAS

Përktheu nga anglishtja: Urim Poshka

Fq: 448  
133 x 205 mm  
Biblioteka



Duke i shërbyer afirmimit të traditës islame shqiptare, përmes kësaj vepre sjellim jetën dhe veprën e një teologu mysliman shqiptar, Faik Hoxhës, i cili edhe përkundër të gjithë peripecive që përjetuan ulematë në kohën e ndalimit të fesë, arriti ta mbrojë dinjitetin e tij, por edhe të gjejë rrugë për t'u shërbyer brezave.

Natyrisht, kjo vepër vjen falë punës së palodhshme edhe të autorit të saj, i cili duke e njohur nga afër Faik Hoxhën, jo vetëm që ka shfaqur respektin e tij për këtë hallkë të rëndësishme të islamit shqiptar, por ka dëshmuar se vërtet di dhe mundet ta realizojë këtë përmes një vepre që i kalon përmasat e një prezantimi përshkrues.

## Faik Hoxha Para pasqyrës së një jete...

MUHAMED SYTARI

Fq: 112  
133 x 205 mm  
Biblioteka





## Fundamentalizmi islam, ç'është ky?

ENES KARIÇ & NUSRET ÇANÇAR

Përktheu nga bosnjakishtja: Nexhat Ibrahim

Fq: 296  
133 x 205 mm  
Biblioteka



"Fundamentalizmi ç'është ky?" në origjinal (boshnjakisht) u botua para më shumë viteve si përmbledhje punimesh nga një tubim me të njëjtin titull, i mbajtur në Sarajevë dhe i organizuar për herë të parë nga Bashkësia Islame asokohe e përbashkët e ish-Jugosllavisë, por për fat të keq pa pjesëmarrjen aktive të shqiptarëve të pranishëm.

Është përmbledhje nga punëtorë shkencorë të cilët asokohe mbase kanë qenë më të thirrurit për ta shqyrtuar këtë çështje dhe për momentin është libër që mundëson për ta kuptuar detyrën kryesore të religjionit, që ka qenë dhe vazhdon të mbetet mbajtja e drejtpeshimit, gjegjësisht e paqes, për çka vetë feja është garanca më e mirë, si për para-fillimin e paqes ashtu dhe për mbarimin e saj. Prandaj, nuk është kjo përmbledhje që u flet të tjerëve për paqësjelljen dhe tolerancën aq të "nevojshme", duke e harruar vetveten. Përkundrazi, është kjo një lloj klithme e hoxhallarëve, teologëve dhe intelektualëve ndaj shkatërrimit bashkëkohor luftarak dhe ndaj valës përmytëse të urrejtjes në rend të parë.



## Jasini

SEJJID KUTUB

Përktheu nga arabishtja:  
Muhamed Mustafa


Fq: 108  
133 x 205 mm  
Biblioteka



Jasini është një vepër që në gjuhën shqipe vjen për të satën herë, jo për shkak të kërkesës së madhe të besimtarëve myslimanë, të cilët janë të lidhur me të jo vetëm për faktin se ajo është ndër kaptinat më të shpesh të lexuara të Kuranit, por edhe për arsye se interpretimi që asaj ia bën autori Sejdi Kutub, është një arritje e veçantë në interpretimet kuranore. E veçanta e këtij botimi është se në të është dhënë teksti arabisht i Jasinit, përkthimi i tij shqip, si dhe interpretimi shkencor nga autori i këtij libri.

## Muhammedi alejhisselam

Figura e Muhamedit a.s. dihet botërisht se është personaliteti që ngjall më shumë kureshtje në të gjitha anët e globit dhe në të gjitha gjuhët e botës. Sado që në gjuhën shqipe deri tash janë bërë libra mbi jetën e Muhamedit a.s., shumica libra të përkthyer, por edhe ca vepra origjinale, megjithatë thuaja të gjitha këto vepra kanë ngelur vetëm në nivelin e përdorimit nga ana e besimtarëve, pra për nevoja të njohjes dhe mesimit të fesë. Kjo do të thotë se në gjuhën shqipe ende pritet të vijnë vepra kapitale shkencore, në të cilat do të mund të referoheshin studiuesit, qofshin teologë a të tjerë, të jetës dhe përmasave pejgamberike të Muhamedit a.s. Për këtë qëllim konsiderojmë se botimi i këtyre pesë librave, të shtrira në gjashtë vëllime, ku është përfshirë një autor turk, një boshnjak, një anglez, një francez i natyralizuar dhe një autor shqiptar, do të jenë pasqyra më e mirë për lexuesin shqiptar evropian që ta njohë, kuptojë dhe pranojë personalitetin e Muhamedit a.s.




## Muhammedi a.s. Jeta I

MUHAMMED HAMIDULLAH

Përktheu nga frengjishtja: Ruzhdi Ushaku

Fq: 552  
176 x 250 mm  
Biblioteka: Mendimi Islam

Kjo vepër për vite të tëra ka shërbyer dhe vazhdon të shërbejë si leksikon i njohje së historisë së Muhamedit a.s. Libri është përkthyer nga gjuha e origjinalit, pra nga frengjishtja, ndërsa duke e pasur parasysh rolin e madh që ka pasur kjo vepër në njohjen e Muhamedit a.s. në Evropë, por sidomos vlerat shkencore, gjuhën akademike dhe autenticitetin e të dhënave historike që jepen në të, konsiderojmë se kështu kjo vepër edhe në kulturën shqiptare do të jetë vepra qendrore dhe burimi i parë i referimit për të gjithë që do të dëshirojnë ta njohin jetën dhe veprën e Muhamedit a.s.




## Muhammedi a.s. Vepra II

MUHAMMED HAMIDULLAH

Përktheu nga frengjishtja: Ruzhdi Ushaku

Fq: 406  
176 x 250 mm  
Biblioteka: Mendimi Islam



## Muhammedi a.s. Jeta e tij sipas burimeve më të hershme

MARTIN LINGS

Përktheu nga anglishtja: Edin Q. Lohja

Fq: 416  
176 x 250 mm  
Biblioteka: Mendimi Islam

Autori anglez Martin Lings përmes këtij libri i ka thyer të gjitha skemat dhe shabllonet e studimit të jetës së Muhamedit a.s. Ky libër ka gjetur përdorim të gjerë në Perëndim, ku është libër themelor për njohjen e Pejgamberit a.s. Aq më tepër që qasja shpirtërore dhe perëndimore ndaj figurës së Pejgamberit në këtë libër është diçka e jashtëzakonshme në studimin e jetës së Pejgamberit a.s.





## Muhammedi a.s. Jeta dhe vepra


VEHBI SULEJMAN GAVOÇI

Fq: 360

176 x 250 mm

Biblioteka: Mendimi Islam

Kjo vepër e botuar në fillim të '90-tave në gjuhën shqipe, nga autori shqiptar, që sot llogaritet edhe ndër dijetarët me repute në botën arabo-islame, është vepra më e plotë shkencore e shkruar në gjuhën shqipe për figurën e Muhamedit a.s. Me këtë vepër përcillet jo vetëm tradita shqiptare për studimin jetës dhe personalitetit të Muhamedit a.s., por edhe ajo klasike arabe, ngase Vehbi Sulejman Gavoçi ka shkruar edhe shumë vepra në gjuhën arabe, që sot janë literaturë e rëndësishme e shkencave islame në botë. Ndërsa për ambientin shqiptar kjo vepër është e rëndësishme, se ajo i bashkëngjitet karvanit të gjatë të veprave botërore që janë shkruar në këtë temë, me çka edhe kulturën shqiptare dhe islamin shqiptar i vendos në atë kolonë të gjatë të librave të rëndësishëm të jetës profetike.



## Muhammedi a.s. dhe Kur'ani

OSMAN NURI HAXHIQ


E përkthyer nga boshnjakishtja:  
Zihni Osmani, Haki Ymeri

Fq: 286

176 x 250 mm

Biblioteka: Mendimi Islam

Ky libër ka qenë burimi i parë i njohjes së Muhamedit a.s. në ish-Jugosllavi. I shkruar nga një orientalist boshnjak, me objektivitet dhe racionalitet maksimal, ky libër ka përjetuar disa ribotime dhe vazhdon të mbetet ndër veprat më të arrira të kulturës myslimane në ish-Jugosllavi të shkruara nga një autor autokton. Po ashtu e kemi parasysht se ky libër gjatë edhe komunizmit ka shërbyer si dritare e njohjes së islamit dhe të Muhamedit a.s. për shumë intelektualë, madje edhe jomyslimanë.



## Tre Muhameda Dy imagjinare, një i vërtetë

MUSTAFA ISLAMOGLLU

Përktheu nga turqishtja: Musa Musai

Fq: 396

176 x 250 mm

Biblioteka: Mendimi Islam

Duke sjellë një vepër të një autori turk mbi Muhamedin a.s. kujtojmë se kemi arritur, së pari ta sjellim edhe një kënd të teologjisë islame turke për personalitetin e Muhamedit a.s., ndërsa, së dyti, me këtë libër kujtoj se do t'ia dalim që ta afrojmë më pranë botëkuptimit njerëzor figurën e Muhamedit a.s.

Ilmihali është një vepër që gjithnjë mbetet aktuale, ngase gjithnjë ndjehet nevoja që ai t'u falsë për mësimet bazë të Islamit. Në të në mënyrë të shkurtër, të qartë dhe praktike ofrohen mësimet themelore të këtij besimi, veçmas zbatimi i tij fizik. Duke qenë një vepër që e ka kaluar testin e kohës, duke rezistuar për vite me radhë ndër shumë vepra të tjera të këtij lloji, vepra e Haxhibajriqit të ndër të tashmë shërben si doracak i pazëvendësueshëm për përmbajtjen që e sjell.



## Ilmihali

FEJZULLAH HAXHIBAJRIQ

Përktheu nga boshnjakishtja: H. Sherif Ahmeti

Fq: 108

133 x 205 mm

Biblioteka



Synimi i këtij punimi është që të jepet një pasqyrë e nivelit të zotërimit të shqipes standarde nga nxënësit e shkollave të mesme të qytetit të Shkupit. Ky punim shkencor paraqet një përpjekje serioze të autorit, dr. Berton Sulejmani, për t'i paraqitur disa çështje problemore të zotërimit të shqipes standarde që shfaqen te nxënësit e shkollave të mesme të qytetit të Shkupit. Studimi i nivelit të zotërimit të shqipes standarde nga nxënësit e shkollave të mesme të qytetit të Shkupit përfshin gabimet e nxënësve të cilat shprehen në të gjitha disiplinat e gjuhësisë, që nga fonologjia, morfologjia, drejtshkrimi, sintaksa, leksiku, e deri te gabimet në përdorimin e shenjave të pikësimit.

## Gjuha standarde shqipe dhe shkolla

BERTON SULEJMANI

Fq: 188

133 x 205 mm

Biblioteka





## Fëmijët e apokalipsit

GYRSEL DONMEZ

Përktheu nga turqishtja: Mithat Hoxha

Fq: 94  
133 x 205 mm  
Biblioteka



Kjo përmbledhje poetike vjen në gjuhën shqipe jo vetëm si hallkë e re në komunikimin ndërkulturor shqiptaro-turk, por edhe si një risi tematike e motivore, që autori i saj ofron përmes mesazhit të tij poetik.

“Fëmijët e apokalipsit” i detyrohet sigurisht edhe gjuhës poetike që vjen përmes shqipërimin të shkëlqyer të përkthyesit tashmë të njohur, Mithat Hoxha.



Poeti kosovar Junuz Fetahaj përmes hartës së lotit edhe një herë sjell moment të asaj historie që krijoi aq shumë momente lotësh. Poeti, duke mos qenë fillestar në mjeshtërinë e poezisë, ia delme sukses të mbarështojë mesazhin e tij poetik dhe këtë ta bëjë me vargje mirë të realizuara.



## Harta e lotit

JUNUZ FETAHAJ

Fq: 94  
133 x 205 mm  
Biblioteka



## Lulet e mërziisë

SHKËLZEN HALIMI

Fq: 112  
133 x 205 mm  
Biblioteka



“Lulet e mërziisë” është një dramë që e ndarë në tre pjesë ofron një tablo që thith nga realiteti i gjysmëshekullit të fundit, ndërsa u referohet librave që kanë mbajtur shënime për ato vite kur shqiptarët mezi ndjenin lirinë. Përmes pak personazheve që i vë në lojë, autori arrin mjeshtërisht të krijojë imazhin e njeriut që përfundon në çmendinë.

Duke mos qenë drama e tij e parë, ndërsa autori një shkrimtar i njohur në Maqedoni e më gjerë, kjo dramë është synon të mbetet një vepër e rëndësishme e dramaturgjisë shqiptare edhe përtej kufijve politikë e etnikë.



Rruga për në Mekë është një rrëfim për një rrugë, që e bën autori i saj, që ndërthur në vete komente, rrëfime dhe ngjarje, që e tipizojnë më së miri botën arabe, por edhe kulturën islame të parë nga syri i një perëndimori në botën e shkretëtirës. Meqë është vepër që është pritur dhe lexuar më ëndje nga shumë popuj në shumë gjuhë, pas një botimi të mëparshëm nga ne në gjuhën shqipe, po e sjellim serish.

## Rruga për në Mekë

MUHAMED ASAD

Përktheu nga anglishtja: Arjol Guni

Fq: 624  
133 x 205 mm  
Biblioteka



## Lypsiqarët e Shkupit

KIM MEHMETI

Duke qenë mjeshtër i rrëfimit, shkrimtari i dëshmuar i prozës shqipe, Kim Mehmeti, edhe përmes kësaj vepre dëshmon se jo vetëm që di të realizojë roman përtej kornizave të ngushta etnike, por ai në këtë vepër i thyen edhe të gjitha skemat e një imagjinate të thjeshtë artistike. Ky roman, që kur lexohet në tërësinë e veprave të tjera, është vetëm një hallkë, megjithatë vjen si një kurorë, në të cilën autori i saj ka derdhur gjithë fuqinë e tij krijuese për t'i vendosur dhe ndërlidhur ngjarjet jo vetëm me vendlindjen e tij, por me Shkupin në përgjithësi, duke përcuar kështu edhe mesazhe politike e historike.



Fq: 264  
133 x 205 mm  
Biblioteka



## Divani

JUNUS EMRE

Përktheu nga turqishtja: Mithat Hoxha




Divani ose Vepra Poetike e poetit kombëtar turk, Junus Emre, është poezi filozofiko-mistike didaktike. Ideja-bosht e tërë veprës është pashmangshmëria e vdekjes e cila përcakton në mënyrë të padiskutueshme për njeriun si qenie joekologjike, domosdoshmërinë e ekzistencës së një bote tjetër që do t'i jepte kuptim jetës dhe veprimtarisë së tij në këtë botë.

Të qëndrosh para Divanit të Junus Emresë, një burri të zemrës, që është përcjellë pothuajse për 700 vjet me radhë nga goja në gojë, që është bërë tekst për këngë dhe himne fetare (ilahí), disa vargje të të cilit janë bërë proverbiale dhe janë përcjellë si të tilla gojë më gojë, si dhe para vetë personalitetit të tij i cili ka dhënë kontribut të madh për formimin e kulturës dhe qytetërimit turk, është me të vërtetë emocioni më i thellë!

Fq: 232  
133 x 205 mm  
Biblioteka



Monografia për Shkupin, e Kim Mehmetit, vjen në gjuhën shqipe nga penda e një shkrimtari e publicisti, i cili pa pretenduar se ofron një vepër shkencore me fusnotizime e referenca, ia ka dalë që të bëjë një prezantim të bukur Shkupit dhe duke u bërë kështu vepra e parë e këtij lloji në gjuhën shqipe dhe për Shkupin. Shto këtu edhe gjuhën publicistike, një stil që ai mjeshtërisht e ka lëvruar ndër vite, kjo monografi për gjatë kohë do të mbetet për shumëçka e veçantë në gjuhën shqipe për qytetin që ngadalë po përmblytet nga uji antishqiptar.



## Shkupi

KIM MEHMETI

Fq: 264  
210 x 235 mm  
Biblioteka



“Pejgamberi im i dashur në 365 ditë” është menduar të jetë mik i shtëpive tuaja çdo ditë, që ashtu t’ua begatojë dhe ndriçojë orët që i kaloni në familjen tuaj. Libri është përgatitur me qëllim që të lexohet gjatë një viti. Për këtë arsye në këtë libër ka 365 tregime të zgjedhura nga jeta e Pejgamberit tonë të dashur. Tregimet janë radhitur në mënyrë kronologjike, andaj ne ju rekomandojmë që bashkë me fëmijën tuaj t’i lexoni nga dita e parë e deri te dita e treqind e gjashtëdhjetë e pestë, ashtu që plotësisht ta mësoni jetën e Pejgamberit tonë të dashur.

## Pejgamberi im i dashur në 365 ditë

NURDAN DAMLLA

Përktheu nga turqishtja: Fatmir Sulaj

Fq: 448  
205 x 285 mm  
Biblioteka





## KQ i NDSH-së dhe Azem Marana

QERIM LITA

Monografia studimore “KQ i NDSH-së në Shkup dhe Azem Marana”, paraqet një përpjekje modeste në rrafshin historik, për ta zbardhë aktivitetin politik, diplomatik, organizativ dhe ushtarak të KQ të NDSH-së në Shkup dhe figurave me emnime të saj.

Nismëtarët e kësaj ideje (për themelimin e NDSH-së) ishin: Azem Marana, Hasan Bilalli, Hysniqemal Ejupi, Qemal Qazimi, Mahmut Dumani, Nebi Jonuzi dhe Nuredin Ibrahim.

Për përgatitjen e kësaj monografie studimore, janë shfrytëzuar materiale të shumta arkivore nga Arkivi Shtetëror i Maqedonisë, nga Agjencioni i Arkivave të Kosovës, nga Arkivi Qendror i Shqipërisë, literatura e botuar nga autorë shqiptarë, shtypi i kohës, dosjet e UDB-ës maqedonase - që kanë të bëjnë me udhëheqësit e NDSH-së në Shkup dhe subjekti njeri-pjesëmarrës në këto ngjarje.



Fq: 416  
176 x 250 mm  
Biblioteka



## Kujtime

NEXHAT IBRAHIMI



Meqë jeta e Nexhat Ibrahimit nuk është një jetë dosido, por është vërtet një jetë e mbushur me momente të cilat brezat e rinj do të duhet t'i mbajnë mend si momente të sakrificës dhe punës, “Logos-A” vendosi që këtë vepër edhe një herë në një botim të posaçëm t’ia sjellë lexuesit shqiptar. Një arsye më shumë pos kësaj, ishte edhe fakti se, derisa seria është një botim që sigurohet pak më vështirë dhe qarkullon në një qark më të ngushtë lexuesish, mbase më profesionalë, vepra “Kujtime” do të duhet të jetë një vepër që do të duhet t’u bjerë në dorë të gjithë atyre që dëshirojnë të dinë më shumë për sakrificat e ylemasë shqiptare, si dhe për përpjekjet vetëmohuese të tyre në shërbim të idealit të lartë islam, human e kombëtar.

Pasi që Nexhat Ibrahim i shkroi këtë vepër falë insistimeve të miqve të tij, mbeti detyrim i yni që këtë ta bëjmë gjerësisht të pranishme nëpër familjet shqiptare, që ajo të shërbejë si inkurajim për gjeneratat e reja, si shembull i mirë për flijimin, vetëmohimin dhe punën që duhet ta ndjekin ata që janë vënë në shërbim të vlerave të mira.

Me këtë botim kujtojmë se kemi përmbushur edhe një detyrim ndaj lexuesve tanë, të cilët ka kohë që e kanë kërkuar një vepër të këtillë.

Fq: 288  
133 x 205 mm  
Biblioteka



## “10 lule për maturë”


Në këtë projekt janë përfshirë 10 tituj për maturantë (prandaj edhe projekti dhe kompleti quhet “10 lule për maturë”) nga kultura elementare islame, mësimet rreth besimit dhe ushtrimit të ibadetit, disa libra letrarë me elemente të kulturës islame, disa libra këshillues për djem e vajza, disa libra të kulturës shpirtërore dhe një libër për kuptimin filozofik e logjik të fesë, besimit.

## Kokë më kokë me të rinjtë

ALI FUAD BASHGIL

Përktheu nga turqishtja: Metin Izeti

Fq: 78  
133 x 205 mm  
Biblioteka: Botime të veçanta



Ali Fuad Bashgil – “Kokë më kokë me të rinjtë” – një libër këshillues për të rinjtë, sidomos për nxënësit e shkollave të mesme. Udhëzues për mësimin, nxënien e diturisë dhe njohjen e të vërtetës.

## Fotografitë e kujtimeve

MILAZIM KRASNIQI

Fq: 138  
133 x 205 mm  
Biblioteka: Botime të veçanta



Milazim Krasniqi – “Fotografitë e kujtimeve” – roman bashkëkohor me vlera të rëndësishme artistike. Një ndërthurje e krajetave shpirtërore që zbulojnë një njeri të ri.

## Vitet e urithit

KIM MEHMETI

Fq: 244  
133 x 205 mm  
Biblioteka: Botime të veçanta



Kim Mehmeti – “Vitet e urithit” – roman bashkëkohor me vlera të dëshmuara letrare. Ky roman ka marrë edhe çmim për roman të vitit 2008.

## Hënëza e natës endeluziane

XHEMALUDIN LLATIÇ

Përktheu nga boshnjakishtja:  
Xhabir Ahmeti

Fq: 198  
133 x 205 mm  
Biblioteka: Botime të veçanta




Xhemaludin Latif – “Hënëza e natës endeluziane” – dramë bashkëkohore me motive historike të kohës myslimane në Spanjë.



## Rruga për njohjen e Zotit MUSTAFA MAHMUD

Përkthyen nga boshnjakishtja:  
Miftar Ajdini, Nexhat Ibrahim, Muhidin Ahmeti

Fq: 262  
133 x 205 mm  
Biblioteka: Botime të veçanta



Mustafa Mahmud – “Pse ta besoj Zotin?” – në të përfshihen dy libra (“Prej dyshimit deri në besim” dhe “Dialog me mikun ateist”) të autorit egjiptian, i cili nga botimet e bëra në gjuhën shqipe në vitet e 90-ta, ka dëshmuar se është i qëlluar për t’u lexuar nga të rinjtë e kësaj moshe.

## “Allahu është një dhe Muhamedi a.s. është Profet i tij” MUSTAFA MAHMUD

E përkthyen nga boshnjakishtja:  
Gazmend Hoxha, Nexhat Ibrahim

Fq: 202  
133 x 205 mm  
Biblioteka: Botime të veçanta



Mustafa Mahmud – “Si ta njoh Allahun dhe Muhamedin a.s.? – në këtë vëllim përfshihen edhe dy librat e tjerë të autorit: “Allahu xh.sh.”, “Muhamedi a.s. Aty jepet një pasqyrë më e plotë e natyrës së besimit islam për maksimumin “Allahu është një dhe Muhamedi a.s. është i dërguar i Tij”

## Besimi – freski e shpirtit ISMET U. SHEHIBRAHIMOVIQ

Përktheu nga boshnjakishtja:  
Mehmet Halimi, Muhidin Ahmeti

Fq: 366  
133 x 205 mm  
Biblioteka: Botime të veçanta




Ismet Shehbrahmoviq – “Besimi – freski e shpirtit” – përfshihen veprat “Fuqia e besimit përsosuri e shpirtit” dhe “Në rrugën e ngushëllimit e të shpresës” që janë libra të mrekullueshëm për një ngritje shpirtërore, për fuqizimin e devotshmërisë, si dhe për të pasur një kulturë më të pasur shpirtërore.

## Hyrje në Islam MUHAMED HAMIDULLAH

E përkthyen nga boshnjakishtja:  
Bahri Aliu & Neshat Xheladini

Fq: 382  
133 x 205 mm  
Biblioteka: Botime të veçanta



Muhamed Hamidullah - “Hyrje në Islam” - Hyrje në islam është libri më gjithëpërfshirës dhe njëherazi më informativ për të gjithë që dëshirojnë të marrin informacionet themelore mbi Islamin. Ky libër, që është edhe përkthimi i parë i literaturës islame në gjuhën shqipe në ish-Jugosllavi, as sot nuk ka humbur aktualitetin dhe freskinë e tij.

## Drita islame në ishullin shqiptar NEXHAT IBRAHIMI

Fq: 186  
133 x 205 mm  
Biblioteka: Botime të veçanta



Nexhat Ibrahim – “Islami dhe muslimanët në tokat shqiptare dhe në Ballkanin mesjetar (shekujt IX - XIV)” – libër me të dhëna elementare historike për kulturën dhe historinë islame të shqiptare

## Ty, rini MUHAMED EL GAZALI, ALI TANTAVI

E përkthyen nga arabishtja:  
Ataullah Aliu, Irfan Salihu

Fq: 134  
133 x 205 mm  
Biblioteka: Botime të veçanta



Ebu Hamid el-Gazali & Ali Tantavi & Mustafa Islamogllu – “Ty rini” – në këtë vëllim do të përfshin vepra këshilluese për rininë: “Biri im” nga Gazaliu, “Bija ime” nga Ali Tantavi dhe “Këshilla” nga Mustafa Islamogllu.



Светата книга на Исламот, Куранот, покрај низа изданија и преводи на стотици странски јазици, пред извесно време беше преведена и на македонски јазик. По големиот интерес, кој го пробуди, нејзиниот преведувач, проф. Џило, се осврна уште еднаш на својот претходен превод, го преработи уште еднаш, го дополни со некои нови забелешки кои беа дадени на првиот превод и така успеа уште еднаш на македонскиот читател да му го понуди на поинаков начин, со надеж дека вака исполнува не само една научна должност, туку и едно лично настојување на пренесување на светиот збор на Исламот и на македонски јазик.

## KUR'AN Prevod HASAN ĆILO

Fq: 722  
133 x 205 mm  
Biblioteka






## Fluturimi mbi Sllupçan

NEHAS SOPAJ

Romani për fëmijë "Fluturim mbi Sllupçan" i autorit Nehas Sopaj, është një libër tërheqës, që të detyron të mos e lëshosh nga dora derisa ta lexosh deri në fund. Nehasi, që e ka matur veten në fushën e poezisë dhe të prozës për të rritur, me këtë roman e bind lexuesin e vogël dhe lexuesin e madh, se ka aftësi të rralla të shkëputet nga bota artistike e të mëdhenjve dhe bashkë me vrundujt e imagjinatës të futet me shumë sukses në botën e fëmijëve, që zien nga fantazia e bujshme dhe nga dëshira për t'i sendërtuar ëndrrat e tyre, sado që nganjëherë duken qesharake dhe nuk mund të jetësohen.



Fq: 176  
133 x 205 mm  
Biblioteka



## Rrëfime mbi pejsamberët për fëmijë

EBU EL-HASAN EN-NEDEVI

Përktheu nga arabishtja: Ataulla Aliu



Janë këto 12 rrëfime për pejsamberët, të cilat vijnë në një botim për fëmijë, duke dhënë jo vetëm informacion për jetën e profetëve më të rëndësishëm të islamit, por edhe krijuar një kulturë të përgjithshme për jetën e tyre, që detyrimisht do t'u duhet fëmijëve.

Gjuha e lehtë rrëfimore, stili i veçantë dhe përshkrimet e bukura, ia dalin që ta mbajë gjallë kureshtjen e fëmijës për të kuptuar se çka ndodhi me Ibrahimin, Jusufin, Nuhun, Hudin, Salihun, Musain, Shuajbin, Sulejmanin, Ejubin, Zekerjanë dhe Isain, gjithnjë duke përfshirë edhe ngjarje të tjera të historisë.

Fq: 288  
133 x 205 mm  
Biblioteka




Pas një sërë botimesh në të kaluarën të botimeve të emërtuar si "Libra xhepi", sivjet kemi vazhduar këtë traditë, duke sjellë disa tituj jo pak të rëndësishëm, gjithnjë duke pasur parasysh se këto janë tekste që lexohen shpejt dhe përcjellin mesazh të cilin lexuesi e merr nga vetëm ato pak faqe. Tashmë kur kemi krijuar edhe pamje të re të këtyre botimeve, kujtojmë se kjo bibliotekë muajve në vijim do të sjellë edhe shumë tituj të ri po kaq të rëndësishëm.

## Arsimimi modern historia, teoritë dhe filozofitë e tij

SEJJID HUSEIN NASR

E përktheu nga anglishtja: Edin Q. Lohja

Fq: 22  
100 x 170 mm  
Biblioteka




BIBLIOTEKA E XHEPIT




## Turk elhamdulillah!

OLSI JAZEXHI

Fq: 22  
100 x 170 mm  
Biblioteka



BIBLIOTEKA E XHEPIT



## Kontributi i Hasan Kaleshit në gjuhësinë shqiptare

MEHDI POLISI

Fq: 20  
100 x 170 mm  
Biblioteka



BIBLIOTEKA E XHEPIT




## Muslimani në kohë

ATAULLAH ALIU

Fq: 24  
100 x 170 mm  
Biblioteka



BIBLIOTEKA E XHEPIT



## Qasje religjioze religjionit

METIN IZETI



Fq: 47  
100 x 170 mm  
Biblioteka




BIBLIOTEKA E XHEPIT

## Qëllimi i arsimit islam

WILLIAM C. CHITTICK

E perktheu nga anglishtja: Edin Q. Lohja



Fq: 30  
100 x 170 mm  
Biblioteka



BIBLIOTEKA E XHEPIT

## Ibn Abbasi, mufesiri i tretë

ATAULLAH ALIU



Fq: 58  
100 x 170 mm  
Biblioteka



BIBLIOTEKA E XHEPIT

## Koncepti i Kur'anit për da'ven

ATAULLAH ALIU



Fq: 52  
100 x 170 mm  
Biblioteka



BIBLIOTEKA E XHEPIT





*LIBRI I VITIT 2010*



LOGOS A